



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

## KOMISIONERI PËR MBROJTJEN NGA DISKRIMINIMI

Nr. 1231/1 Prot.

Tiranë, më 12 / 09 / 2018

### V E N D I M

#### Nr. 174 , Datë 12 / 09 / 2018

Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, bazuar në ligjin nr. 10 221, datë 04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, mori në shqyrtim ankesën nr.51 Regj., datë 24.04.2018, e znj.E. Xh kundër Inspektoriatit Shtetëror të Mjedisit, Pyjeve dhe Ujërave (ISHMPU), me pretendimin për diskriminim për shkak të “*gjendjes arsimore*”.

Në përfundim të shqyrtimit të ankesës, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi<sup>1</sup>,

### K O N S T A T O I :

#### **I. Parashtrimi i fakteve sipas subjektit ankues.**

Subjekti ankues ka qenë në marrëdhënie pune me Inspektoriatin Shtetëror të Mjedisit, Pyjeve dhe Ujërave, nga data 07.12.2016 deri në datën 18.04.2018, datë në të cilën është firmosur urdhëri për lirim të saj nga detyra. Kronologjia e ngjarjeve që reflektohen në formularin e ankesës është e tillë:

Me shkresën nr.7742 prot., datë 07.12.2016 të Departamentit të Administratës Publike, znj.Xh është emëruar në pozicionin e specialistes në Sektorin e Burimeve Njerëzore dhe Komunikimit, në Drejtorinë Juridike të ISHMPU-së.

Me shkresën nr.2409 prot., datë 21.12.2016 drejtuar Departamentit të Administratës Publike (DAP-it), ISHMPU-ja ka refuzuar emërimin e znj.Xh duke cilësuar se e kishin shpallur këtë vend në formularin e rekrutimit me kriterin e arsimit në Fakultetin e Filologjisë, Dega Gazetari dhe se arsyeja e zgjedhjes me këtë kriter është përcaktimi në përshkrimin e punës dhe mbulimi i komunikimit me mediat.

Me shkresën nr.8010/1 prot., datë 09.01.2017 DAP-i ka kthyer përgjigje duke konkluduar se znj.Xh plotëson kriteret e përcaktuara në shpalljen për konkurim dhe i kërkon ISHMPU-së marrjen e masave për zbatimin e aktit të emërimit.

<sup>1</sup> Në vijim do t'i referohemi me shkurtesën: KMD.

Në këto kushte, ISHMPU-ja me Urdhërin nr.19, datë 16.01.2017 ka lidhur marrëdhëniet e punës me znj.Xh. Pa kaluar 4 muaj nga emërimi i saj në këtë pozicion pune, znj.Xh me shkresën nr.2086 prot., datë 28.04.2017 është njoftuar për fillimin e procedimit disiplinor ndaj saj.

Procedimi disiplinor ndaj saj është inicuar bazuar tek Memoja nr.2085 prot., datë 28.04.2017 e përgjegjëses, eprorit direkt, znj.K. Memoja i referohet faktit që ankuesja nuk ka arsimimin e duhur për pozicionin e specialistes së Burimeve Njerëzore dhe Komunikimit pranë ISHMPU-së.

Znj.Xh e ka kundërshtuar këtë fakt dhe me shkresën e datës 04.05.2017 ka kërkuar sqarime nga titullari mbi faktet dhe provat tek të cilat mbështetej memoja në fjalë. Po ashtu, ajo ka kundërshtuar këtë fakt tek DAP-i dhe Komisioneri për Mbikqyrjen e Shërbimit Civil (KMSHC).

Me shkresën nr.2422 prot., datë 18.05.2017 të ISHMPU-së është njoftuar për pjesëmarrje në Komisionin Disiplinor, i cili do të mbahej në datën 23.05.2017. Komisioni nuk u mbledh gjatë 60 ditëve në vijim dhe për këtë arsye çështja u arkivua.

Ankuesja shprehet se ka kërkuar disa herë të njihet me vlerësimin e saj të punës, gjë që nuk ka ndodhur deri me datën 04.04.2018. Me konkluzionet e këtij vlerësimi znj.Xh është njohur me datë 10.04.2018, kur përgjegjësjë e sektorit (znj.K) i ka dorëzuar formularin e vlerësimit një vjeçar të punës me vlerësimin “jo kënaqshëm”, me shënimin: *“Sugjerohet moskonfirmimin e nëpunësit. Vlerësimi i hartuar gabim. Nuk ka arritur të dallojë nocionin e rishikimit të ndërmjetëm dhe vlerësimit vjetor, i cili zbatohet në rastin e nëpunësit në periudhë prove<sup>2</sup>”*.

Lidhur me sa mësipër, ankuesja shprehet se ka ankimuar vlerësimin e punës dhe nuk ka marrë asnjë përgjigje nga ISHMPU-ja dhe se me datë 18.04.2018 është nxjerrë Urdhëri nr.140, “Për Lirimin nga Detyra”.

Ankuesja rendit gjithashtu këto fakte, si veprime diskriminuese nga ana e punëdhënësit ndaj saj :

- Nuk ka qenë e akomoduar në Zyrën e Burimeve Njerëzore, sikurse dy koleget e tjera të zyrës, por është lënë në zyrën e inspektorëve të Mjedisit, me të cilët nuk ka patur asnjë lidhje të drejtëpërdrejtë pune.
- Gjatë kohës së qëndrimit të saj në këtë institucion nuk ka qenë e pajisur me kompjuter dhe tavolinë personale pune.
- Nuk i është lënë asnjë kopje e shkresave të konceptuara prej saj, por i janë mbajtur në dosjen e përgjegjëses së Sektorit, znj.K.
- Shkresat e konceptuara prej saj, në protokollin e institucionit rezultojnë sikur janë hartuar nga kolegja e zyrës, znj.B dhe jo prej saj.

---

<sup>2</sup> Referuar formularit të vlerësimit të punës për ankuesen, znj.Xh.

Në përfundim të ankesës, znj.Xh kërkon konstatimin e diskriminimit nga ana e ISHMPU-së, për shkak të gjendjes arsimore.

## **II. Ndjekja e procedurës për shqyrtimin e ankesës nga Komisioneri.**

Në nenin 1 të ligjit nr. 10 221/2010, parashikohet objekti i këtij ligji, duke u sanksionuar se: *“Ky ligj rregullon zbatimin dhe respektimin e parimit të barazisë në lidhje me gjininë, racën, ngjyrën, etninë, gjuhën, identitetin gjinor, orientimin seksual, bindjet politike, fetare ose filozofike, gjendjen ekonomike, arsimore ose shoqërore, shtatzaninë, përkatësinë prindërore, përgjegjësinë prindërore, moshën, gjendjen familjare ose martesore, gjendjen civile, vendbanimin, gjendjen shëndetësore, predispozicione gjenetike, aftësinë e kufizuar, përkatësinë në një grup të veçantë, ose me çdo shkak tjetër”.*

Neni 7 i LMD-së<sup>3</sup>, në pikën 1 të tij, parashikon se: *“ Çdo veprim apo mosveprim i autoriteteve publike ose i personave fizikë a juridikë që marrin pjesë në jetën dhe sektorët publikë apo privatë, që krijojnë baza për mohimin e barazisë ndaj një personi apo grupi personash, ose që i ekspozon ata ndaj një trajtimi të padrejtë dhe jo të barabartë, kur ata ndodhen në rrethana të njëjta apo të ngjashme, në krahasim me persona të tjerë apo grupe personash, përbën diskriminim”.*

Bazuar në nenin 32/1/c të ligjit, Komisioneri ka kompetencë për të shqyrtuar shkeljet që i bëhen zbatimit dhe respektimit të parimit të barazisë në lidhje me këto shkaqe.

### **Përsa më lart, referuar nenit 33, të ligjit nr. 10 221/2010, ankesa përmban elementët e kërkuar nga ky ligj.**

1. Me shkresën me nr.553/2 prot., datë 07.05.2018 i është kërkuar informacion ISHMPU-së, lidhur me pretendimin e znj.Xh<sup>4</sup>.

Me shkresën nr.2222/1 prot., datë 07.06.2018, ISHMPU-ja ka informuar Komisionerin se: *“...arsyeja e lirimit të znj.Xh është moskonfirmimi si nëpunës civil, në detyrën e*

<sup>3</sup> Shkurtesë për Ligjin për mbrojtjen nga diskriminimi.

<sup>4</sup> Argumentim lidhur me pretendimet e subjektit ankues.

- Kopje të kontratës së punës të znj.E Xh.
- Kopje e vlerësimit të punës të subjektit ankues, nëse ka.
- Informacion lidhur me performancën e tij në punë, nëse ka.
- Një kopje e dosjes personale të znj.E Xh.
- Kriteret që kërkohen për pozicionin e punës që kishte ankuesja.
- Informacion nëse ankuesja e ka kundërshtuar shkresërisht (në rrugë administrative) vlerësimin e performancës. Nëse po, një kopje të shkresës së ankueses, si dhe të shkresës kthim përgjigje nga ana e Juaj.
- Informacion nëse ankuesja e ka kundërshtuar gjyqësisht vlerësimin e performancës. Nëse po, një kopje të aktit. (kërkesë padisë)
- Informacion nëse në vend të znj.Xh është emëruar një punonjës/e tjetër. Nëse po, një kopje të procedurës për emërimin e saj/tij.
- Një kopje e dosjes personale të personit të emëruar në vend të znj.Xh.
- Çdo informacion tjetër që ju do e gjykoni të arsyeshëm se do të ndihmonte në sqarimin e plotë të kësaj çështjeje.

*Specialistes të Burimeve Njerëzore dhe Komunikimit, në Drejtorinë Juridike të ISHMPU-së. Ky pozicion, aktualisht vakant, është pjesë e Drejtorisë Juridike, Prokurimeve, Burimeve dhe Komunikimit dhe si i tillë, rekrutimi i të gjithë punonjësve duhet të bëhet duke iu nënshtruar procedurave të rekrutimit...”. ISHMPU-ja ka informuar Komisionerin se pozicioni Specialist pranë Sektorit të Burimeve Njerëzore dhe Komunikimit, aktualisht është vakant, si dhe ka dërguar bashkëngjitur përgjigjes një pjesë të dokumentacionit të kërkuar.*

2. Me shkresën me nr.553/4 prot., datë 13.06.2018 Komisioneri ka kërkuar informacion dhe dokumentacion shtesë pranë ISHMPU-së, me qëllim vlerësimin sa më të drejtë të problematikave të çështjes në fjalë, duke specifikuar:
  - *“Pretendimin e ankueses se z.E. T, i cilësuar si nëpunësi civil më i vjetër i njësisë organizative, nuk ka tagrin ligjor për të dhënë mendimin e tij lidhur me performancën e saj në punë gjatë periudhës së provës, për arsye se; së pari, z.T nuk bën pjesë në të njëjtën njësi organizative ku ajo është emëruar në periudhë prove. Ankuesja është emëruar në Sektorin e Burimeve Njerëzore dhe Komunikimit, ndërsa z.T është Përgjegjës i Sektorit të Inspektimit të Industrisë dhe Veprimtarisë Prodhuese në Drejtorinë e Mjedisit. Së dyti, nuk ka asnjë urdhër që z.T të ishte caktuar si punonjësi më i vjetër civil që duhet t’i jepte udhëzime për punën apo nën kujdesin e të cilit ajo të ishte vendosur.*
  - *Lidhur me këto pretendime, ju lutemi, cilësoni cila ishte marrëdhënia hierarkike e punës mes subjektit ankues dhe z.E T?*
  - *A ka një lidhje të drejtëpërdrejtë apo të tërthortë hierarkike sa i takon detyrave funksionale, mes Specialistit të Sektorit të Burimeve Njerëzore dhe Komunikimit dhe Përgjegjësit të Sektorit të Inspektimit të Industrisë dhe Veprimtarisë Prodhuese? Nëse po, me çfarë provohet? Një kopje të akteve të hartuara që të mund të provojnë këtë ndërveprim të ndërsjelltë. (Psh nëse ka, shkresa të hartuara nga znj.Xh dhe të sigluara nga z.T)*
  - *Një dokument ku evidentohet fakti se z.T është punonjësi më i vjetër civil i njësisë organizative ku znj.Xh ishte emëruar në periudhë prove.*
  - *A ka ndonjë urdhër/shkresë ku është cilësuar fakti se z.T është caktuar si punonjësi më i vjetër civil nën kujdesin e të cilit ishte vendosur znj.Xh, si punonjëse në periudhë prove? Nëse po, një kopje të shkresës”.*

Me shkresën me nr.2222/3 prot., datë 04.07.2018 ISHMPU-ja i është përgjigjur Komisionerit duke cituar se: *“Z.T, është nëpunësi më i vjetër, i cili ka dhënë mendimin për të gjithë nëpunësit e tjerë që kanë qenë në periudhë prove pranë institucionit tonë”.* Theksojmë se, shkresa nuk ka asnjë dokument bashkëngjitur për të provuar sa më sipër dhe asnjë parashtrim apo informacion lidhur me kërkesat e tjera të paraqitura nga Komisioneri.

3. Mbështetur në nenin 33, pika 8, të ligjit nr.10 221/2010 "Për Mbrojtjen nga Diskriminimi", për shqyrtimin e mëtejshëm të çështjes së znj.Xh, Komisioneri me datë 18.07.2018 realizoi një seancë dëgjimore<sup>5</sup>.

Në seancë ishte i pranishëm vetëm subjekti ankues, znj.Xh; ndërsa nga ana e ISHMPU-së nuk u paraqit asnjë përfaqësues<sup>6</sup>, megjithëse referuar kuponit postar me kod: RR 371 191 641 AA, kishin marrë dijeni që me datë 11.07.2018.

4. Me shkresën me nr.1182 prot., datë 07.08.2018 Komisioneri i ka kërkuar informacionin dhe dokumentacionin shtesë<sup>7</sup> ISHMPU-së.

Me shkresën me nr.2222/5 prot., datë 17.08.2018 ISHMPU-ja ka informuar Komisionerin se: *“Numri i punonjësve në periudhë prove pranë ISHMPU në nivel qendror, gjatë 5 viteve të fundit, është 17. Numri i punonjësve të konfirmuar në detyrë si nëpunës civil është 12. Z.E T ka qenë nëpunësi më i vjetër që në krijimin e ISHMPU-së në nivel qendror për konfirmimin e punonjësve të ISHMPUT në nivel qendror, në periudhë prove”*. Bashkëlidhur ISHMPU-ja ka dërguar dhe kopje të praktikave të mbajtura për konfirmimin në detyrë për 12 punonjës.

### **III. Vlerësimi i fakteve dhe provave gjatë shqyrtimit të çështjes nga Komisioneri.**

#### **A. Lidhur me pretendimin e ankuesit se është trajtuar në mënyrë të pabarabartë dhe të disfavorshme nga ana e ISHMPU-së.**

Ligji “Për mbrojtjen nga diskriminimi”, neni 1 sipërcituar dhe neni 3/1, parashikojnë se: *“Diskriminim” është çdo dallim, përjashtim, kufizim apo preferencë, bazuar në cilindo shkak të përmendur në nenin 1 të këtij ligji, që ka si qëllim apo pasojë pengesën apo bërjen të pamundur të ushtrimit në të njëjtën mënyrë me të tjerët, të të drejtave e lirive themelore të njohura me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë, me aktet ndërkombëtare të ratifikuara nga Republika e Shqipërisë, si dhe me ligjet në fuqi”*.

<sup>5</sup>Në zbatim të Njoftimit me nr.982 prot., datë 10.07.2018, të Komisionerit.

<sup>6</sup> Referuar procesverbalit të mbajtur në Zyrën e KMD-së me datë 18.07.2018, ora 12:00 -12:

<sup>7</sup> *“Sa është numri i punonjësve që kanë qenë në periudhë prove pranë ISHMPU-së, gjatë 5 viteve të fundit?*

*Sa është numri i punonjësve që janë konfirmuar në detyrë si nëpunës civil?*

*A ka qenë z.E T nëpunësi i autorizuar nga ISHMPU, si nëpunësi më i vjetër civil për të dhënë mendimin me shkrim për çdo punonjës në periudhë prove, gjatë 5 viteve të fundit? Nëse po, një dokument ku evidentohet fakti se z.T është punonjësi më i vjetër civil i ISHMPU-së, si dhe kopje të praktikave të mbajtura për secilin rast (ku të mund të evidentohet dhënia e mendimit të z.T për çdo punonjës në periudhë prove gjatë 5 viteve të fundit pranë institucionit tuaj).*

*Kopje të urdhërave, me anë të të cilëve z.T ishte caktuar si punonjësi më i vjetër civil nën kujdesin e të cilit ishin caktuar të gjithë punonjësit në periudhë prove, gjatë 5 viteve të fundit pranë ISHMPU-së; kopje e dokumentacionit për secilin rast”*.

Gjatë shqyrtimit të ankesës dhe ndjekjes së procedurës hetimore, Komisioneri në përputhje me ligjin ka këruar informacionin e nevojshëm dhe dokumentacionin mbështetës, lidhur me rastin e znj.Xh, në mënyrë që të mund të vlerësonte me objektivitet pretendimin e saj për trajtim të pabarabartë dhe diskriminues.

Kodi i Procedurës Administrative<sup>8</sup>, ka saktësuar se barra e provës në çështjet e diskriminimit të pretenduar, i kalon palës tjetër/organit publik, në këtë rast ISHMPU-së. Pra, në këtë rast ISHMPU duhet të provontë se subjekti ankues nuk është trajtuar në mënyrë të padrejtë, të pabarabartë dhe më pak të favorshme, për shkakun e pretenduar prej saj.

Komisioneri ka përmbushur kërkesat e parashikuara në Kodin e Procedurës Administrative, edhe sa i takon dhënies së ndihmës efektive, gjë e cila është përcaktuar në nenin 10, të tij: *“ Organi publik siguron që të gjitha palët dhe persona të tjerë të përfshirë në procedurë të jenë në gjendje të ndjekin dhe të mbrojnë të drejtat dhe interesat e tyre ligjorë në mënyrë sa më efektive dhe të lehtë të jetë e mundur. Ai i informon palët mbi të drejtat dhe detyrimet e tyre, përfshirë të gjithë informacionin e lidhur me procedurën dhe i paralajmëron ato për pasojat ligjore të veprimeve ose mosveprimeve të tyre”*.

LMD në nenin 32, pikën 2, të tij ka përcaktuar qartë këtë detyrim, duke cituar se: *“Të gjitha institucionet publike dhe subjektet private janë të detyruara të mbështesin komisionerin në përmbushjen e detyrave të tij, veçanërisht duke i dhënë informacionin që i nevojitet atij”*.

Nga ana e Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi janë marrë të gjitha masat që subjekti kundër të cilit është bërë ankesa të vihet në dijeni për ankesën e bërë dhe i janë ofruar mundësitë që të jepte shpjegime, informacion dhe dokumentacion provues mbi pretendimet e ngritura nga subjekti ankues. (Referuar kuponit postar “Lajmërim marrje” me kod postar RR 263 042 033 AA dhe RR 245 083 629 AA shkresat e Komisionerit janë protokolluar pranë ISHMPU).

Nga këqyrja e dokumentacionit të depozituar nga subjekti ankues rezulton se, znj.Xh ka filluar punë pranë ISHMPU Tiranë me datë 16.01.2017<sup>9</sup> në pozicionin “Specialist” në Sektorin e Burimeve Njerëzore dhe Komunikimit, në Drejtorinë Juridike, Prokurimit, Burimeve Njerëzore dhe Komunikimit. Kjo marrëdhënie pune ka zgjatur deri në datën 18.04.2018, datë kur asaj i është komunikuar urdhëri për lirim të tij nga detyra. Në dosjen e ankueses është depozituar dokumentacioni provues lidhur me kualifikimin e saj:

- Diplomë nr.13600, e Fakultetit të Ekonomisë/Universiteti i Tiranës, ku i jepet titulli: Administrator Biznesi/profile Menazhim Biznesi<sup>10</sup>.
- Diplomë Master i Nivelit të Dytë me nr.423, në fushën: Administrim Biznesi<sup>11</sup>.

---

<sup>8</sup>Kështu, neni 82, pika 2 e tij, përcakton se: *“Në rastet kur pala paraqet prova mbi të cilat bazon pretendimin për sjelljen diskriminuese dhe në bazë të të cilave mund të prezumohet se ka pasur diskriminim, pala tjetër dhe/ose organi publik detyrohet të provojë se faktet nuk përbëjnë diskriminim, pavarësisht nga detyrimi i organit publik për të vënë në dispozicion të palëve provat e zotëruara prej saj”*.

<sup>9</sup> Referuar librezës së punës së ankueses.

<sup>10</sup> Nr.Regj.13924, datë 04.07.2002.



- Certifikatë për përfundimin e kursit të trajnimit të detyrueshëm për nëpunësit civilë në periudhë prove, e Shkollës Shqiptare të Administratës Publike<sup>12</sup>.

Nga kronologjia e ngjarjeve dhe fakteve konstatohet se:

Referuar Ligjit nr.152/2013 “Për Nëpunësin Civil”, i ndryshuar, dhe VKM-së nr.243, datë 18.03.2015 “Për pranimin, lëvizjen paralele, periudhën e provës dhe emërimin në kategorinë ekzekutive”, DAP-i është njësi përgjegjëse për organizimin e procedurave të pranimit në shërbimin civil. Në këtë kuadër, DAP-i ka zhvilluar procedurën e rekrutimit për pozicionin Specialist të Burimeve Njerëzore në institucionet e administratës shtetërore, duke e grupuar pozicionin sipërcituar në shpalljen me nr.1147, lloji i diplomës “Shkenca Shoqërore”, niveli minimal i diplomës “Bachelor”.

- Me shkresën me nr.7742 prot., datë 07.12.2016 të Departamentit të Administratës Publike (DAP), subjekti ankues, znj.E Xh është emëruar nëpunës civil në periudhë prove, në pozicionin Specialist në Sektorin e Burimeve Njerëzore dhe Komunikimit, në Drejtorinë Juridike, Prokurimit, Burimeve Njerëzore dhe Komunikimit, pranë ISHMPU-së.
- Me shkresën me nr.8409 prot., datë 21.12.2016 ISHMPU-ja i është drejtuar shkresërisht DAP-it duke i bërë me dije refuzimin e emërimit të znj.E Xh në pozicionin Specialist në Sektorin e Burimeve Njerëzore dhe Komunikimit, në Drejtorinë Juridike, Prokurimit, Burimeve Njerëzore dhe Komunikimit, pranë ISHMPU-së, duke cituar se:

*“Së pari, ne si institucion e kemi shpallur këtë vend në formularin e rekrutimit me kriterin e edukimit me Fakultet të Filologjisë, Dega Gazetari. Arsyeja e zgjedhjes me këtë kriter është përcaktimi në përshkrimin e punës dhe mbulimi i komunikimit me mediat. Pas komunikimit me punonjësit përkatës të DAP-it na vënë në dijeni se, për pozicionin Specialist në Sektorin e Burimeve Njerëzore dhe Komunikimit, në Drejtorinë Juridike, Prokurimit, Burimeve Njerëzore dhe Komunikimit, pranë ISHMPU-së, duhet kriteri me Fakultetin e Drejtësisë ose Fakultetin e Shkencave Sociale.*

*Së dyti, institucioni jonë ka dërguar në rrugë elektronike, ndryshimin e kriterit të edukimit për këtë pozicion pune, pasi në faqen e hedhjes së vendeve vakante nuk mund të punoje rreth ndryshimeve të kriterëve.*

*Bëjmë me dije se znj.Xh ka përfunduar studimet në Fakultetin e Ekonomisë, gjë që nuk përputhet me pozicionin e Sektorit të Burimeve Njerëzore dhe Komunikimit”.*

Lidhur me sa mësipër, ISHMPU-ja ka kërkuar nga ana e DAP-it që të përzgjidhet kandidat tjetër fitues dhe jo znj.Xh. Kandidati tjetër duhet të përshtatet me kriteret e kërkuara, si dhe me përshkrimin e pozicionit të punës.

<sup>11</sup> Nr.diplome 423, datë 02.06.2011.

<sup>12</sup> Urdhër nr.19, datë 16.01.2017i Kryeinspektorit/ISHMPU.

- Nga ana tjetër, pranë DAP-it është ankuar për mosekzekutim të urdhërit të emërimit me nr.7742, datë 07.12.2016 dhe vetë subjekti, znj.E Xh.
- Me shkresën me nr.8010/1 prot., datë 09.01.2017 DAP-i i është drejtuar rishtazi ISHMPU-së, duke i kërkuar marrjen e masave nga ana e tyre (ISHMPU-së), për zbatimin e aktit të emërimit me nr.7742, datë 07.12.2016 për znj.Xh.

Pas këtyre komunikimeve shkresore me DAP-in, ISHMPU-ja me Urdhërin nr.19, datë 16.01.2017<sup>13</sup> ka emëruar znj.E Xh në pozicionin Specialist në Sektorin e Burimeve Njerëzore dhe Komunikimit, në Drejtorinë Juridike, Prokurimit, Burimeve Njerëzore dhe Komunikimit.

Theksojmë se, marrëdhëniet e krijuara mes znj.Xh si punëmarrëse dhe titullarit të ISHMPU-së, në cilësinë e punëdhënësit kanë qenë të acaruar që në fillës të tyre. Kjo ardhur si rezultat i kontestimit të kriterit të arsimimit të ankueses nga ana e këtij institucioni. Situata është përkeqësuar në vijim, gjë e cila konstatohet nga kronologjia e fakteve të ndodhura. Kështu, konstatojmë:

- Pavarësisht se është emëruar nga DAP-i me datë 06.12.2016, marrëdhëniet financiare ISHMPU-ja i ka lidhur me ankuesen me datë 17.01.2017, si shkak i refuzimit fillimisht të emërimit të saj nga ana e institucionit, sikurse është cituar më lart në shtjellim të vendimit.
- Gjatë vitit 2017 ankuesja ka punuar në kushtet e presionit të vazhdueshëm, kjo provuar dhe nga fakti se, brenda 4 muajve të parë të punës në ISHMPU, me shkresën me nr.2086 prot., datë 28.04.2017 ndaj saj filloi një procedim disiplinor; i cili meqenëse Komisioni nuk u mbledh brenda 60 ditëve, çështja u arkivua.
- Në vijim, në muajin Tetor 2017, përgjegjësja e subjektit ankues, i jep asaj masën disiplinore “Vërejtje”, të cilën znj.Xh e ka kundërshtuar. Me shkresën me nr.1674/1 prot., datë 23.10.2017, Komisioneri për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil ka vendosur arkivimin e çështjes, duke evidentuar se: *“...pasi u analizua informacioni dhe pasi u verifikua paraprakisht rasti, rezultoi se ndodhemi në rrethanat kur nuk evidentohen element të ecurisë disiplinore, që në këtë rast, duhet të kryhet nga drejtori i drejtorisë, në kuptim të eprorit direkt sipas ligjit dhe jo nga përgjegjësi i sektorit, si në rastin në fjalë. Po kështu, nuk u evidentua asnjë propozim për të filluar ecuri disiplinore ndaj nëpunëses, pranë ndonjë organi të ecurisë disiplinore, të parashikuar nga neni 59, i Ligjit për Nëpunësin Civil. Sa më sipër, nuk evidentohen shkaqe ligjore për fillimin e hetimit administrative”*.
- Znj.Xh, në respektim të parashikimeve të Kreut VI, të VKM-së nr.243, datë 18.03.2015 “Për pranimin, lëvizjen paralele, periudhën e provës dhe emërimin në kategorinë ekzekutive”, ka përfunduar periudhën e provës dhe trajnimin pranë ASPA-s në periudhën 18-29 Shtator 2017.
- Megjithëse nga ana e titullarit të institucioni në muajin Dhjetor 2017 duhet të inicioheshin procedurat për marrjen e Statusit të Nëpunësit Civil për punonjësen E Xh, kjo procedurë u zgjat deri në muajin Prill 2018.

<sup>13</sup> Referuar shkresë me nr.185 prot., datë 16.01.2017 të ISHMPU-së.



- Me datë 10 Prill 2018 subjekti ankues është njohur me vlerësimin 1 vjeçar të punës të bërë nga përgjegjësja e sektorit, znj.A K, e cila e ka vlerësuar “jo kënaqshëm” dhe ka sugjeruar moskonfirmimin e ankueses si nëpunëse civile.
- Me datë 12.04.2018 znj.Xh ka kundërshtuar vlerësimin e punës “Jo kënaqshëm”, duke parashtruar argumentat e saj lidhur me opinionin e shprehur tek formulari i vlerësimit sa i takon realizimit të detyrave nga ana e saj, të cilat poshtë citohen:

Subjekti ankues nga muaji Janar 2017 kur ka filluar marrëdhëniet e punës me ISHMPU-në deri në momentin e largimit nga puna, ka hartuar mbi 150 shkresa, për 7 (shtatë) Qarqet e ISHMP-së që ka administruar (Tiranë, Durrës, Dibër, Gjirokastrë, Korçë, Lezhë dhe Vlorë), të cilat janë të protokolluara pranë institucionit.

Ankuesja nga muaji Mars 2017 e në vijim, ka administruar sistemin HRMIS për 60 (gjashtë dhjetë) punonjës të ISHMPU-së, në nivel qendror dhe ka hedhur në mënyrë të saktë dhe të përpiktë të gjithë dokumentacionin e nevojshëm për çdo punonjës. Ka asistuar dhe ndihmuar në mënyrë të vazhdueshme personat përgjegjës për sistemin HRMIS në të gjitha Qarqet e institucionit.

Gjatë muajve Shkurt-Prill 2017 ankuesja ka trajtuar problematikat që kanë patur të gjitha Qarqet e institucionit lidhur me mungesën e fotove për kartat e inspektorëve, të kërkuara nga Inspektorati Qendror.

Nga viti 2017 e në vijim ankuesja ka qenë pjesë e 7 (shtatë) Komisioneve.

Nga muaji Janar 2018 e në vijim, deri në zgjidhjen e marrëdhënieve të punës znj.Xh ka qenë në grupin e punës për ndjekjen e problematikave të punonjësve të ISHMPU-së lidhur me Ujësjetë Kanalizimet sh.a (UK) si dhe OSHEE sh.a. (Korresponcën si koordinatorë për të drejtën e informimit, ankuesja e ka depozituar në dosje; ndërsa barrën e provës lidhur me shkresat e hartuara prej saj drejtuar bashkive të vendit për UK përkatëse dhe OSHEE ia ka ngarkuar institucionit, duke cituar se ato ndodhen në protokollin e ISHMPU-së).

Nga ana tjetër, subjekti ankues ka shfrytëzuar mundësitë për trajnim<sup>14</sup>.

Lidhur me pretendimin se ankuesja nuk ka realizuar dhe përmbushur si duhet detyrat e saj si specialiste e Sektorit të Burimeve Njerëzore dhe Komunikimit, në Drejtorinë Juridike të ISHMPU-së; duhej të ishte ISHMPU-ja që duhet të provonte të kundërtën, në referim të përmbysjes së barrës së provës, sikurse është sipër cituar në vendim. ISHMPU-ja nuk është treguar bashkëpunuese në këtë pikë, duke mos sjellë informacionin dhe dokumentet e kërkuara që të mund të provonte të kundërtën e asaj që pretendon znj.Xh.

---

<sup>14</sup> Ka kryer trajnimin e detyruar pranë Shkollës së Administratës Publike. (datë 18-29 Shtator 2017, ku është vlerësuar me 22 pikë nga 28 tot.)

- Në muajin Shkurt 2017 ka marrë pjesë në trajnimin e financiar nga Bashkimi Evropian, me tematikë: “Menaxhimi i Stafit dhe Performancës. Mbështetje për Reformën e Shërbimit Civil në Shqipëri.
- Në muajt Shkurt-Mars-Prill 2017 ka marrë pjesë në trajnimin e organizuar nga Departamenti i Administratës Publike, me tematikë: “Implementimi i sistemit të menaxhimit të Regjistrat Qendror të Personelit (HRMIS)”.

Bazuar në Kodin e Procedurës Administrative, të ndryshuar, ku saktësohet se barra e provës në çështjet e diskriminimit të pretenduar, i kalon palës tjetër/organit publik, në këtë rast ISHMPU-së, e cila duhet të provonte se subjekti ankues nuk është trajtuar në mënyrë të padrejtë, të pabarabartë dhe më pak të favorshme, për shkakun e pretenduar.

Referuar shkresës me nr.1599 prot., datë 16.04.2018 “Vendim”, moskonfirmimi si nëpunës civil pas periudhës së provës i znj.E Xh është bazuar në tre elementë:

- Mendimin me shkrim të z.E T, nëpunësi civil më i vjetër i njësisë organizative.
- Vlerësimin e rezultateve individuale në punë gjatë periudhës së provës.
- Përfundimin e trajnimit të detyruar të ASPAS-s.

➤ Lidhur me mendimin me shkrim të dhënë nga z.E T, Komisioneri konstaton se: Me anë të shkresës me nr.1570 prot., datë 13.04.2018 “Dhënie mendimi për nëpunësin në përfundim të periudhës së provës” znj.E Xh, citohet se z.E T, në cilësinë e nëpunësit civil më të vjetër të njësisë organizative ku punon dhe znj.Xh, ka vlerësuar negativisht këtë punonjëse duke cilësuar se: “...nuk është e përkushtuar në punë, nuk përmbush me performancë minimale detyrat brenda sektorit, nuk ka bashkëpunim me specialistët, Përgjegjësen e Sektorit, si dhe me kolegët e tjerë të Institucionit. Nuk ka aftësi individuale për sa i takon profesionalizmit në përmbushjen e funksioneve të Specialistes së BNJK, si dhe punës në grup”. Në përfundim z.Te ka sugjeruar që znj.Xh të mos konfirmohet në këtë pozicion pune.

Komisioneri konstaton se nëpërmjet shkresave me nr.2222/3 prot., datë 04.07.2018 dhe nr.2222/5 prot., datë 17.08.2018 të ISHMPU-së vërtetohet fakti se z.T, është nëpunësi i cili ka dhënë mendimin për të gjithë nëpunësit e tjerë që kanë qenë në periudhë prove pranë ISHMPU-së gjatë 5 vitevetë fundit. Kështu, ai ka dhënë mendim në përfundim të periudhës së provës për nëpunësit:

R.B me detyrë Specialiste në Burimet Njerëzore, I.M me detyrë Specialiste Finance, N.SH, M.D me detyrë Specialiste në Arkiv-Protokoll, P.Ç me detyrë Drejtor në Drejtorinë e Financës dhe Shërbimeve Mbështetëse, P.M me detyrë Inspektor në Drejtorinë e Inspektimit Mjedisor, J.T , I.B me detyrë Inspektorë, E.SH me detyrë Specialiste në Sektorin e Financës, R.SH me detyrë Specialiste Finance, S.B me detyrë Specialiste IT, J.N me detyrë Specialiste Juriste.

*Lidhur me sa më lart*, Komisioneri thekson se, ISHMPU-ja, pavarësisht citimit të faktit se z.Tela është nëpunësi civil më i vjetër pranë këtij institucioni, nuk ka sjellë asnjë dokumentacion (megjithëse i është kërkuar specifikisht nga Komisioneri) për të provuar se:

1. Z.T është nëpunësi civil më i vjetër i njësisë organizative ku punonte znj.Xh.
2. Z.T dhe znj.Xh janë punonjës të së njëjtës njësi organizative.
3. Z.T ishte caktuar si nëpunësi civil i cili do të kishte në kujdes nëpunësen në periudhë prove, znj.Xh.

4. Z.T lidhur me sa më sipër kishte tagrin për të dhënë mendim për nëpunësen, znj.Xh në përfundim të periudhës së provës.

Pavarësisht, sa më sipër, vërehet se z.T ka qenë nëpunësi që ka dhënë mendimin për të gjithë punojësit e tjerë në periudhë prove, gjatë 5 viteve të fundit në ISHMPU në nivel qendror; sikurse janë cituar më lart, rast pas rasti. Verifikohet se punonjësit sipërcituar kanë qenë pjesë e drejtorive apo sektorëve të ndryshëm pranë ISHMPU-së. Pra, në vijim të kësaj logjike, pretendimi i ankueses se është trajtuar në mënyrë të pabarabartë dhe të disfavorshme nga ana e ISHMPU-së, përmes dhënies së mendimit me shkrim për të nga punonjësi E.T, (si punonjës që nuk nuk bën pjesë në të njëjtën njësi organizative me atë ku ishte emëruar znj.Xh në periudhë prove<sup>15</sup>), nuk qëndron; pasi ai ka dhënë mendimin e tij me shkrim dhe për 12 punonjës të tjerë, të cilët po ashtu nuk bëjnë pjesë në të njëjtën njësi organizative më të<sup>16</sup>.

Pra, znj.Xh nuk është trajtuar në mënyrë të pabarabartë dhe të disfavorshme nga ana e ISHMPU-së sa i takon faktit së dhënies së mendimit me shkrim për të nga ana e punonjësit E.T, pasi një praktikë e tillë është ndjekur edhe për 12 punonjës të tjerë, në kushte të njëjta me ankuesen.

Referuar ligjit nr.152/2013 “Për Nëpunësin Civil”, të ndryshuar, dhe VKM-së nr.243, datë 18.03.2015 “Për pranimin, lëvizjen paralele, periudhën e provës dhe emërimin në kategorinë ekzekutive” është përcaktuar se, nëpunësi që emërohet për herë të parë në shërbimin civil, i nënshtrohet një periudhe prove që zgjat një vit nga data e aktit të emërimit. Po ashtu, në Kreun VI “Periudha e provës” në piukën 2, të kësaj VKM-je është përcaktuar se gjatë periudhës së provës nëpunësi është i detyruar të ndjekë:

- a) Programin e detyrueshëm të trajnimit për periudhën e provës pranë ASPA-s.
- b) Udhëzimet e nëpunësit më të vjetër civil, nën kujdesin e të cilit ai është vendosur.

Pika 3 e kësaj VKM-je përcakton se: “Nëpunësi më i vjetër civil përzgjidhet nëpunësi, i cili ka vjetërsinë më të madhe në detyrë dhe që bën pjesë në të njëjtën njësi organizative ku është emëruar nëpunësi në periudhë prove”.

Theksojmë se lidhur me pikën a) punonjësja e ka përmbushur, ndërsa për pikën b) duhet të sillte dokumentacion provues pala ndaj së cilës është paraqitur ankesa, për të provuar, e para se z.T ishte nëpunësi më i vjetër civil me vjetërsinë më të madhe në detyrë; dhe e dyta se z.T bën pjesë në të njëjtën njësi organizative ku ishte e emëruar dhe punonjësja Xh, për të cilën ai ka dhënë mendimin.

Komisioneri konstaton se procedura e ndjekur lidhur me vlerësimin e nëpunëses në periudhë prove është bërë jo konform parashikimeve ligjore dhe në shkelje të tyre, pasi

<sup>15</sup> Ankuesja ishte emëruar në Sektorin e Burimeve Njerëzore dhe Komunikimit, ndërsa z.T është Përgjegjës i Sektorit të Inspektimit të Industrisë dhe Veprimtarisë Prodhuese në Drejtorinë e Mjedisit.

<sup>16</sup> Referuar paragrafit 2, fq.11 të vendimit.

dhënia e mendimit me shkrim duhet të bëhet nga nëpunësi më i vjetër i njësisë organizative ku bën pjesë dhe punonjësja që vlerësohet. Mirëpo, në kushtet kur ky vlerësim është bërë nga i njëjti person për të gjithë punonjësit në periudhë prove, Komisioneri vlerëson se jemi në kushtet e paligjshmërisë nga ana e institucionit dhe jo të trajtimit të pabarabartë të ankueses krahasuar me të punonjësit e tjerë në periudhë prove.

Pika 6 e po kësaj VKM-je përcakton se, vendimi në përfundim të periudhës së provës merret bazuar në rezultatin e testimit në përfundim të ciklit të detyrueshëm të trajnimit të ASPAS-s dhe vlerësimit të rezultateve individuale në punë, i cili bëhet sipas procedurave të përcaktuara në VKM për vlerësimin e arritjeve vjetore.

Bazuar në sa më sipër, Komisioneri vlerëson se:

- a) Rezultati i testimit të punonjësës në periudhë prove, znj.Xh lidhur me përfundimin e ciklit të detyrueshëm të trajnimit të ASPA-s ka qenë pozitiv, pasi nga 28 pikët e mundshme ajo ka marrë 22 pikë.
- b) Ndërsa, sa i takon vlerësimit të rezultateve individuale të kësaj punonjësje; vlerësimi i punës “jo kënaqshëm” i cili ka vijuar me vendimin<sup>17</sup> për moskonfirmimin si nëpunës civil pas periudhës së provës për znj.E Xh duke konkluduar me largimin e saj nga puna<sup>18</sup>, është diskrecion i vetë institucionit.

Neni 7, pika 1, e ligjit “Për mbrojtjen nga diskriminimi” parashikon se: *“Çdo veprim ose mosveprim i autoriteteve publike ose i personave fizikë a juridikë që marrin pjesë në jetën dhe sektorët publikë ose privatë, që krijojnë baza për mohimin e barazisë ndaj një personi apo grupi personash, ose që i ekspozon ata ndaj një trajtimi të padrejtë dhe jo të barabartë, kur ata ndodhen në rrethana të njëjta ose të ngjashme, në krahasim me persona të tjerë ose grupe të tjera personash, përbën diskriminim”.*

Në këto kushte, referuar nenit 7, pika 1, të ligjit nr. 10 221, datë 04.02.2010 “Për mbrojtjen nga diskriminimi, Komisioneri gjykon se subjekti ankues, znj.E Xh nuk i është nënshtruar një trajtimi të pabarabartë dhe disfavorizues, nga ana e ISHMPU-së, sa i takon caktimit të nëpunësit E.T për dhënie e mendimit me shkrim për të, lidhur me praktikën e konfirmimit të saj në detyrë.

Për sa më lart, Komisioneri konstaton se znj.Xh është nuk trajtuar në mënyrë të pabarabartë dhe të pafavorshme nga ana e ISHMPU-së.

## **B. Lidhur me shkakun e pretenduar nga ankuesja si shkak të sjelljes diskriminuese ndaj saj nga ana e ISHMPU-së.**

<sup>17</sup> Referuar shkresës me nr.1599 prot., datë 16.04.2018 të ISHMPU-së.

<sup>18</sup> Referuar Urdhërit nr.140, datë 18.04.2018 të ISHMPU-së.

Për të vërtetuar se ndaj subjektit ankues ka një sjellje diskriminuese nga ana e ISHMPU-së, duhet të ekzistojë një lidhje shkakësore ndërmjet shkakut të pretenduar nga ankuesja, sipas parashikimeve të ligjit “Për mbrojtjen nga diskriminimi”<sup>19</sup> dhe trajtimit të pafavorshëm të saj.

Bazuar në dokumentacionin që disponojmë nga hetimi, Komisioneri vlerëson se ankuesja mbart shkakun e pretenduar, atë të gjendjes arsimore.

“Gjendja arsimore” është shkak, për të cilin Ligji nr.10 221, datë 4.2.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, ofron mbrojtje. Në nenin 1 të tij përcaktohet se: “Ky ligj rregullon zbatimin dhe respektimin e parimit të barazisë në lidhje me gjininë, racën, ngjyrën, etninë, gjuhën, identitetin gjinor, orientimin seksual, bindjet politike, fetare ose filozofike, gjendjen ekonomike, arsimore ose shoqërore, shtatzaninë, përkatësinë prindërore, përgjegjësinë prindërore, moshën, gjendjen familjare ose martesore, gjendjen civile, vendbanimin, gjendjen shëndetësore, predispozicione gjenetike, aftësinë e kufizuar, përkatësinë në një grup të veçantë, ose me çdo shkak tjetër”.

Çështjet e diskriminimit kërkojnë që të vërtetohet nëse ekziston një përlligje e arsyeshme për trajtimin ndryshe të evidentuar.

Bazuar në Ligjin nr.152/2013 “Për Nëpunësin Civil”, të ndryshuar, dhe VKM-në nr.243, datë 18.03.2015 “Për pranimin, lëvizjen paralele, periudhën e provës dhe emërimin në kategorinë ekzekutive”, DAP-i është njësi përgjegjëse për organizimin e procedurave të pranimit në shërbimin civil. (Në këtë kuadër, DAP-i ka zhvilluar procedurën e rekrutimit për pozicionin Specialist të Burimeve Njerëzore në institucionet e administratës shtetërore).

Si dhe, bazuar në shpalljen e DAP-it me nr.1147, lloji i diplomës “Shkenca Shoqërore”, niveli minimal i diplomës “Bachelor”, për pozicionin “Specialist” në Sektorin e Burimeve Njerëzore dhe Komunikimit, në Drejtorinë Juridike, Prokurimit, Burimeve Njerëzore dhe Komunikimit pranë ISHMPU-së, znj.E Xh plotësonte kërkesat e shpallura për këtë pozicion pune.

### **C. Lidhja e trajtimit të pafavorshëm me shkakun e mbrojtur.**

Lidhur me pretendimin e ISHMPU-së për mosplotësim të kriterëve arsimore të znj.Xh, është shprehur DAP-i, që është njësi përgjegjëse për organizimin e procedurave të pranimit në shërbimin civil, i cili ka kërkuar marrjen e masave nga ana e tyre (ISHMPU-së), për zbatimin e aktit të emërimit me nr.7742, datë 07.12.2016 për znj.Xh, pasi përmbush kriterin arsimor për pozicionin e punës si specialiste në Sektorin e Burimeve Njerëzore dhe

---

<sup>19</sup> Në interpretim të nenin 1, të ligjit “Për mbrojtjen nga diskriminimi”, “...ky ligj rregullon zbatimin dhe respektimin e parimit të barazisë në lidhje me gjininë, racën, ngjyrën, etninë, gjuhën, identitetin gjinor, orientimin seksual, bindjet politike, fetare ose filozofike, gjendjen ekonomike, arsimore ose shoqërore, shtatzaninë, përkatësinë prindërore, përgjegjësinë prindërore, moshën, gjendjen familjare ose martesore, gjendjen civile, vendbanimin, gjendjen shëndetësore, predispozicione gjenetike, aftësinë e kufizuar, përkatësinë në një grup të veçantë, ose me çdo shkak tjetër”.

Komunikimit, në Drejtorinë Juridike të ISHMPU-së. Pra, subjekti ankues kishte arsimin dhe kualifikimin e duhur për pozicionin e punës si specialiste në Sektorin e Burimeve Njerëzore dhe Komunikimit, në Drejtorinë Juridike të ISHMPU-së.

ISHMPU-ja ka vijuar marrëdhëniet e punës me ankuesen për rreth një vit, duke ia njohur dhe pranuar të mirëqenë kriterin arsimor në përputhje me pozicionin e punës. (ardhur kjo pas komunikimit shkresor të institucionit me DAP-in).

Komisioneri thekson faktin se, ankuesja përmbushte kriterin arsimor për pozicionin e punës, dhe ajo nuk është larguar nga puna për këtë shkak; por për arsye të moskonfirmimit të saj si nëpunëse civile në detyrën e Specialistes të Burimeve Njerëzore dhe Komunikimit, në Drejtorinë Juridike të ISHMPU-së., fakt të cilin Komisioneri e vlerëson si diskrecion të vetë institucionit. Si rrjedhojë, kriteri arsimor nuk ka shërbyer si shkak për moskonfirmimin e saj në detyrë.

Për sa më sipër, Komisioneri vlerëson se, subjekti ankues, znj.E Xh nuk është diskriminuar nga ana e punëdhënësit, ISHMPU, për shkak të gjendjes së saj arsimore.

#### **PËR KËTO ARSYE :**

Mbështetur në nenet 3, 4, 7, pika 1, nenin 32, pika 1, gërma a), si dhe nenin 33, pikat 1, 3, 5, 7 të Ligjit nr. 10 221, datë 04.02.2010 “Për mbrojtjen nga diskriminimi”,

Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi,

#### **V E N D O S I :**

1. Konstatimin e mosdiskriminimit për shkak të gjendjes arsimore, të znj.E Xh, nga ana e Inspektoriatit Shtetëror të Mjedisit, Pyjeve dhe Ujërave (ISHMPU-së).
2. Kundër këtij vendimi lejohet ankim në gjykatë, brenda 45 ditëve nga marrja dijoni, sipas parashikimeve ligjore të Kodit të Procedurave Administrative, të ndryshuar.

**KOMISIONERI**

**Robert GAJDA**

(shkaku: gjendja arsimore)

(fusha: punësim)